




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 12, datë 11.1.2017



P Ë R

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.97, DATË 7.2.2012,**  
**TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN**  
**E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË AUTORITETIT RRUGOR**  
**SHQIPTAR"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 3, të ligjit nr.10164, datë 15.10.2009, "Për Autoritetin Rrugor Shqiptar", me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.97, datë 7.2.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
  - a) Lidhja nr.1, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
  - b) Lidhja nr.2, e përmendur në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi këtij vendimi të përballohen nga buxheti i miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

3. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

MINISTRI I TRANSPORTIT  
DHE INFRASTRUKTURËS

SOKOL DERVISHAJ

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSMINISTRI


BAHRI SHAQIRI





LIDHJA NR. 1

STRUKTURA E AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

## V E N D I M

Nr. 276, datë 16.5.2018

### P Ë R

### MIRATIMIN E MËNYRËS SË ORGANIZIMIT, TË STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE STATUTIT TË AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3, të ligjit nr.10164, datë 15.10.2009, "Për Autoritetin Rrugor Shqiptar", dhe të nenit 4, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

### V E N D O S I:

#### I. Organizimi dhe funksionimi

1. Autoriteti Rrugor Shqiptar është person juridik publik, me qendër në Tiranë, dhe e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ai organizohet në nivel qendror, nëpërmjet zyrës qendrore, dhe në nivel rajonal, nëpërmjet drejtorive rajonale. Hapja dhe mbyllja e drejtorive rajonale bëhet në kuadër të miratimit të strukturës dhe organikës së Autoritetit Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti Rrugor Shqiptar, më poshtë Autoriteti, ushtron veprimtarinë e tij në bazë të ligjit për Autoritetin Rrugor Shqiptar dhe akteve nënligjore të

dala në zbatim të tij, i cili organizohet dhe funksionon mbi bazën e këtij statuti dhe të rregullores së miratuar nga Bordi Drejtues.

3. Organet e Autoritetit janë:
  - a) Bordi Drejtues;
  - b) Drejtori i Përgjithshëm.
4. Drejtori i Përgjithshëm mbështetet në veprimtarinë e tij nga një zëvendësdrejtor i përgjithshëm.
5. Drejtoritë rajonale përfaqësohen nga drejtori i drejtorisë rajonale. Ato zbatojnë dhe kontrollojnë veprimtarinë e Autoritetit në hapësirën e tyre administrative.
6. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të Përgjithshëm, nëpunësve të tjerë dhe punonjësve të Autoritetit, në nivel qendror dhe rajonal, rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.
7. Emërimi i drejtorit të Përgjithshëm dhe i drejtorëve të drejtorive rajonale bëhet sipas përcaktimeve në ligjin për Autoritetin Rrugor Shqiptar.
8. Emërimet e nëpunësve të Autoritetit bëhen sipas një procedure konkurrimi. Rregullat dhe organet e ngarkuara për zhvillimin e procedurës së konkurrimit, të ngritjes në detyrë, lëvizjes paralele, transferimit, disiplinës në punë dhe të procedurave disiplinore përcaktohen në rregulloren e brendshme të Autoritetit.
9. Autoriteti, për realizimin e funksioneve të përcaktuara në ligj dhe në këtë vendim, harton buxhetin vjetor, që miratohet nga Bordi Drejtues. Ministri, në përputhje me ligjin për Autoritetin Rrugor Shqiptar, autorizon për çdo vit financiar përdorimin e fondeve të miratuara në buxhetin e shtetit për funksionimin e Autoritetit.
10. Të ardhurat e autoritetit krijohen nga:
  - a) fondet e miratuara në buxhetin e shtetit për Autoritetin;
  - b) të ardhurat e mbledhura nga veprimtaria e Autoritetit;
  - c) burime të tjera, dhurime, grante nga burime kombëtare e ndërkombëtare.

11. Autoriteti mban dokumentacionin në përputhje me legjislacionin financiar në fuqi. Ai përgatit raportin dhe llogaritë financiare në fund të çdo viti financiar.
12. Raporti vjetor dhe programi i veprimtarisë së ardhshme financiare miratohen nga Bordi Drejtues.
13. Autoriteti u përgjigjet kërkesave specifike të informacionit, që mund të kërkojë gjatë vitit ministria përgjegjëse për financat për pjesën e buxhetit që finançohet nga buxheti i shtetit.
14. Mbajtja e kontabilitetit dhe auditimi, nga ana e Autoritetit, bëhen në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
15. Bordi mund të vendosë të kërkojë auditim të jashtëm, nëse e konsideron të nevojshëm.
16. Autoriteti ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare. Stema e Autoritetit përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.
17. Drejtoritë rajonale të Autoritetit kanë stemat, logot dhe vulat e tyre zyrtare. Stema e secilës drejtori rajonale përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Drejtoria Rajonale.....”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.
18. Vula e Autoritetit dhe vulat e secilës drejtori rajonale kanë format dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vulat prodhohen, administrohen dhe ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## **II. Funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e Autoritetit Rrugor Shqiptar**

1. Autoriteti kryen funksionet dhe detyrat e mëposhtme:
  - a) Ofron shërbime dhe lëshon autorizime/leje/miratime në përputhje dhe zbatim të Kodit Rrugor e legjislacionit në fuqi;

- b) Krijon dhe mirëmban sistemin për administrimin e rrugëve shtetërore dhe të urave;
- c) Krijon qendrat e menaxhimit elektronik të trafikut dhe miraton statusin e tyre;
- ç) Asiston në përditësimet vjetore dhe rishikimet pesëvjeçare të Planit Kombëtar të Transportit për sektorin e transportit rrugor, në bashkëpunim me Institutin e Transportit;
- d) Mirëmban dhe zbaton Manualin Shqiptar të Ndërtimit të Rrugëve dhe Specifikimet Teknike;
- dh) Merr nisma për studime, kërkime shkencore dhe eksperimente për efikasitetin, trafikun, qarkullimin dhe sigurinë rrugore;
- e) Përgatit programe afatmesme zhvillimi dhe programin vjetor të punës për ndërtimin, rikonstruksionin, mirëmbajtjen, ruajtjen dhe zhvillimin e rrugëve shtetërore, në përputhje me përparësitë e përcaktuara në dokumentet strategjike;
- ë) Përgatit një raport vjetor për ministrinë përgjegjëse dhe Bordin, ku pasqyron veprimtarinë e kryer dhe planin në vazhdim;
- f) Raporton te ministri përgjegjës për veprimtarinë e realizuar, në përputhje me ligjin për Autoritetin Rrugor Shqiptar;
- g) Kërkon informacion nga institucionet publike, qendrore apo vendore, në lidhje me fushën e tij të përgjegjësisë dhe realizimin e detyrave të tij;
- gj) Bashkëpunon me institucione të huaja dhe organizata joqeveritare në fushën e rrjeteve të transportit rrugor;
- h) Negocion, lidh marrëveshje bashkëpunimi me karakter teknik, në fushën e rrjeteve të transportit rrugor, me institucione të huaja homologe, duke ndjekur procedurat ligjore në fuqi;
- i) Anëtarësohet në organizma ndërkombëtarë;
- j) Ka të drejtë të hartojë e të nxjerrë udhëzime, urdhëresa, rregullore dhe akte të tjera administrative, nëpërmjet organeve të tij drejtuese, në mbështetje dhe zbatim të akteve ligjore e nënligjore dhe të kompetencave që i janë dhënë;
- k) Mban librat kontabël, harton të dhënat financiare dhe raportet për gjendjen e ecurisë së veprimtarisë, përfshirë edhe raportet e kontrollit të ekspertëve kontabël të autorizuar, në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare;
- l) Çdo funksion tjetër të parashikuar dhe lejuar nga Kodi Rrugor, ligji për Autoritetin Rrugor Shqiptar dhe legjislacioni në fuqi.

2. Drejtoritë rajonale kryejnë funksionet dhe kanë përgjegjësitë, si më poshtë vijon:

- a) Në përputhje me programin e miratuar nga organet eprorë, marrin të gjitha masat për realizimin e treguesve të këtij programi si dhe të gjithë aktivitetit teknik në mirëmbajtjen e rrjetit rrugor që kanë në administrim;
- b) Përgatisin programe afatmesme zhvillimi dhe programin vjetor të punës për ndërtimin, rikonstruksionin, mirëmbajtjen, ruajtjen dhe zhvillimin e rrugëve shtetërore, në përputhje me përparësitë e përcaktuara në dokumentet strategjike;
- c) Realizojnë procedurat e prokurimit të investimeve dhe shpenzimeve, në përputhje me legjislacionin përkatës, ndjekin zbatimin e kontratave që kanë në zhvillim dhe mbajnë përgjegjësi të plotë për realizimin e tyre, në përputhje me çfarë parashikohet në to;
- ç) Garantojnë siguri për të gjithë përdoruesit e rrugës në të gjitha veprimtaritë që organizojnë për përmbushjen e detyrimeve, sipas Kodit Rrugor;
- d) Organizojnë programin e supervizionit të shërbimeve të mirëmbajtjes me performancë (rutinë dhe dimërore), të rehabilitimit të Rrjetit Rrugor Kombëtar në administrim si dhe ndjekin kontratat;
- dh) Krijojnë dhe mirëmbajnë sistemin për administrimin e rrugëve shtetërore dhe të urave nën administrim;
- e) Mirëmbajnë dhe zbatojnë manualin shqiptar të ndërtimit të rrugëve dhe specifikimet teknike;
- ë) Krijojnë qendrat e menaxhimit elektronik të trafikut dhe miratojnë statusin e tyre;
- f) Asistojnë në përditësimet vjetore dhe rishikimet pesëvjeçare të PKT-së për sektorin e transportit rrugor, në bashkëpunim me Institutin e Transportit;
- g) Marrin nisma për studime, kërkime shkencore dhe eksperimente për efikasitetin, trafikun, qarkullimin e sigurinë rrugore;
- gj) Marrin masa për ruajtjen dhe administrimin e mirë të pronës shtetërore në administrim dhe përgjigjen për dëmtimet e saj;
- h) Ngrenë shtabet e emergjencave për periudhën dimërore (apo kur është e nevojshme), në bashkëpunim me prefekturën dhe Policinë e Shtetit, për mirëmbajtjen e akseve rrugore në administrim.

### 3. Përgjegjësitë dhe detyrat e drejtorit të Përgjithshëm janë:

- a) Siguron drejtimin dhe administrimin efektiv të Autoritetit;
- b) Siguron zbatimin e politikave të Autoritetit dhe të kërkesave të tjera ligjore për këtë Autoritet;
- c) Përfaqëson Autoritetin në ministrinë përkatëse dhe në marrëdhënie me të tretë;

- ç) Bashkëpunon në hartimin e politikave që synojnë përmirësimin e veprimtarisë së Autoritetit dhe vë në dijeni bordin për këto politika;
- d) Emëron dhe shkarkon nëpunësit/punëmarrësit dhe personelin e nevojshëm të Autoritetit;
- dh) Merr pjesë në mbledhjet e bordit pa të drejtë vote;
- e) Propozon për miratim në bord rregulloret e brendshme të Autoritetit, raportet afatmesme të zhvillimit dhe raportin vjetor të punës;
- ë) Drejton veprimtarinë e ARRSH-së në përputhje me këtë vendim, rregulloret dhe vendimet e miratuara nga bordi;
- f) Miraton përshkrimet e punës së zyrës qendrore dhe të zyrave vendore;
- g) Përfaqëson Autoritetin në marrëdhëniet juridike me të tretët, mediat;
- gj) Zbaton vendimet e bordit dhe raporton para tij për veprimtarinë e vet;
- h) U delegon kompetencat drejtorive rajonale të Autoritetit;
- i) Mund të ngrejë komisione ose komitete “*ad-hoc*” për të ndihmuar në kryerjen e funksioneve të tij;
- j) Këshillohet me specialistë të jashtëm për çështje që kanë të bëjnë me njohuri të veçanta;
- k) Lidh marrëveshje ndërinstitucionale për shkëmbimin në mënyrë të vazhdueshme të informacionit të nevojshëm për veprimtarinë e Autoritetit me entet private dhe publike;
- l) Lidh marrëveshje me institucione të huaja ose organizata joqeveritare në fushën e veprimtarisë, sipas dispozitave ligjore në fuqi;
- ll) Miraton marrjen pjesë në aktivitete ndërkombëtare, sipas marrëveshjeve të miratuara;
- m) Nxjerr urdhra e udhëzime të ndryshme për mbarëvajtjen e punës së Autoritetit dhe vendos sanksione, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- n) Emëron sekretarin e bordit;
- nj) Ngre struktura/njësi të brendshme;
- o) Kryen detyra të tjera, që i ngarkon bordi.

4. Në Autoritetin Rrugor Shqiptar funksionon këshilli teknik, i cili jep mendime, propozime, kryesisht të karakterit teknik e rregullator, që kanë të bëjnë me strategjitë në fushën e infrastrukturës rrugore, ideimin e objekteve të reja, ecurinë e punimeve në objekte ekzistuese, cilësinë, afatin e realizimit, në objekte kryesisht të karakterit rrugor, si dhe me detyrimet e të drejtat e Autoritetit, kryesisht, në fushën e investimeve, të asistencës teknike në fushën e ndërtimeve rrugore dhe të veprave të artit, që lidhen me to.

### III. Bordi Drejtues

1. Bordi Drejtues është përgjegjës për menaxhimin e veprimtarisë së autoritetit. Bordi përbëhet nga 7 anëtarë, përkatësisht:

- a) 1 përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për transportin rrugor;
- b) 1 përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për financat;
- c) 1 përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për pronën shtetërore;
- ç) 1 përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për pushtetin vendor;
- d) 1 përfaqësues nga shoqata e kontraktorëve;
- dh) 1 përfaqësues nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë;
- e) 1 përfaqësues nga Shoqata e Inxhinierëve Konsulentë.

2. Anëtarët e bordit emërohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e institucioneve përkatëse, për një afat pesëvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, ose për aq kohë sa anëtari është përfaqësues i organit përkatës. Kriteret dhe kushtet për t'u zgjedhur anëtar i bordit si dhe rastet e lirit të tyre përcaktohen në ligjin për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

3. Drejtori i Përgjithshëm ngarkon një punonjës të autoritetit, i cili miratohet nga bordi, që të kryejë funksionin e sekretarit të bordit. Detyrat e hollësishme të sekretarit të bordit përcaktohen në rregulloren e brendshme të Autoritetit.

4. Bordi ka këto kompetenca:

a) Përcakton politikat e biznesit të Autoritetit, duke u bazuar në:

- programet dhe prioritetin e qeverisë lidhur me infrastrukturën rrugore;
- detyrimet kontraktuale, që lindin nga marrëveshjet në fuqi që ARRSH-ja ka me ministrinë e linjës;
- strategjitë e hartuara nga organet drejtuese të ARRSH-së apo prioritetet e identifikuara si të tilla nga ARRSH-ja.

b) Është përgjegjës për vendimet që rregullojnë veprimtarinë e Autoritetit lidhur me:

- veprimtarinë me impakt financiar për ARRSH-në;
- propozimet për zgjerimin apo zvogëlimin e veprimtarisë së ARRSH-së;
- asetet e ARRSH-së.

c) Është përgjegjës për miratimin e rregulloreve të brendshme të Autoritetit dhe miraton rregulloren dhe ndryshimet përkatëse të saj, duke u bazuar në modelin e propozuar nga drejtori i Përgjithshëm, si një nga organet drejtuese të ARRSH-së.

ç) Është përgjegjës për miratimin e programeve të brendshme vjetore dhe të buxhetit korrespondues të Autoriteti, duke u bazuar në programet financiare/buxhetore të propozuara nga drejtori i Përgjithshëm, ministri i linjës apo ato të përcjella për zbatim nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

5. Rregullat për mbledhjet, kuorumin dhe vendimet e bordit përcaktohen në rregulloren e brendshme të Autoritetit.

#### **IV. Struktura dhe organika**

1. Struktura e Autoritetit Rrugor Shqiptar është sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Struktura e Drejtorisë së Rajonit Qendror (Tiranë) është sipas skemës 1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Struktura e Drejtorisë së Rajonit Verior (Shkodër) është sipas skemës 1/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
4. Struktura e Drejtorisë së Rajonit Jugor (Gjirokastrë) është sipas skemës 1/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
5. Organika e Zyrës Qendrore të Autoritetit Rrugor Shqiptar është sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi është pjesë përbërëse e tij.
6. Organika e Drejtorisë së Rajonit Qendror (Tiranë) është sipas skemës 2/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
7. Organika e Drejtorisë së Rajonit Verior (Shkodër) është sipas skemës 2/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
8. Organika e Drejtorisë së Rajonit Jugor (Gjirokastrë) është sipas skemës 2/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
9. Numri i punonjësve të Autoritetit Rrugor Shqiptar është, gjithsej, 169 veta.

#### **V. Dispozita të fundit**

1. Për nëpunësit civilë aktualë të Autoritetit zbatohen dispozitat e legjislacionit për nëpunësin civil në rastin e mbylljes dhe të ristrukturimit të institucionit.

2. Vendimi nr.97, datë 7.2.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Rrugor Shqiptar”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**SENIDA MESI**


**MINISTRI I INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË**

**DAMIAN GJIKNURI**

**Në mungesë dhe me porosi**


**ZËVENDËSMINISTRI**

**ARTAN SHKRELI**



# STRUKTURA E AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR

SKEMA 1





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 1374 prot.

Tiranë, më 7.2.2019

Lënda: Dërgohet Raporti i veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2018.

**DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM**  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"**  
**Tiranë.**

Në zbatim të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", neni 14, germa "ç", të Manualit të Auditimit të Brendshëm, si dhe të shkresës tuaj nr. 279, datë 9.01.2019 "Mbi raportin e veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2018", bashkëlidhur ju dërgojmë Raportin e veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, për vitin 2018, si edhe pyetësorin e plotësuar të vetëvlerësimit për Auditimin e Brendshëm.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

Sonila Qato





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 574/1 prot.

Tiranë, më 7.2.2019

Lënda: Dërgohet Raporti i veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2018.

**KOMITETIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM PRANË MINISTRISË  
SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit  
Tiranë.

Në zbatim të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, neni 14, germa ”ç”, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, si dhe të shkresës tuaj nr. 279, datë 9.01.2019 ”Mbi raportin e veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2018”, bashkëlidhur ju dërgojmë Raportin e veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, për vitin 2018, si edhe pyetësorin e plotësuar të vetëvlerësimit për Auditimin e Brendshëm.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

Sonila Qato

